

## **KLSH merr pjesë në Workshop-in mbi Opsionet e Thjeshtuara të Kostove (Simplified Cost Options)**

Në datat 15-16 shkurt 2024 në Ministrinë e Financave, në Tiranë, u zhvillua workshopi i parë organizuar në kuadrin e projektit të financuar nga BE "Mbështetje për Formulimin e Programit Operativ" mbi Opsionet e Thjeshtuara të Kostove (*Simplified Cost Options*) në kuadër të përgatitjeve për fillimin e Programit Operativ të BE-së për Punësimin e të Rinjve 2023-2027, financiar në kuadër të Instrumentit të Para-Aderimit IPA dhe i bashkë financuar nga Buxheti i Shtetit Shqiptar dhe për të cilin, Ministria e Financave/CFCU është caktuar si Autoriteti Kontraktor.

Gjatë ditës së parë të workshopit u trajtuan tematika lidhur me njohjen e opsioneve të thjeshtuara të kostos (*Simplified Cost Options*), të cilat përfaqësojnë një devijim nga parimi i kostove reale. Ato mund të përdoren në lidhje me fondet IPA në përputhje me Rregulloren Financiare të BE-së dhe procedurat PRAG. Megjithatë, deri më tani, SCO-të janë përdorur vetëm nga



institucionet/organizatat shqiptare në kontekstin e programeve të bashkëpunimit ndërkuftar Interreg. Duke qenë se SCO-të janë një metodë kyçe për zbatimin e Fondeve të Kohezionit pas anëtarësimit, Shqipëria duhet të përgatitet për miratimin e tyre. Në këtë kuadër, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16/11.01.2024, përfshin në kreun 22 "Përcaktimin dhe miratimin e masave të thjeshtuara për zbatimin e politikës së kohezionit duke përfshirë metodologjitë kombëtare për opsionet e kostove të thjeshtuara."

Në ditën e dytë, u zhvilluan ushtrime për arsyetimin e kostove të vlerësuara bazuar në SCO, si dhe u trajtua kontrolli dhe auditimi i SCO-ve, duke përfshirë vlerësimin ex-ante të metodologjisë, fushëveprimin e verifikimeve, auditimin e metodës së llogaritjes si dhe parregullsitë e mundshme (gabime dhe mashtrime) të lidhura me përdorimin e SCO-ve.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë workshop nga z. Aldo Kume, znj. Anjeza Gjoci dhe z. Sigi Zaimi, auditues në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore.